

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (OFID), PËR PROJEKTIN E PUNIMEVE PËR RIPARIME EMERGJENTE TË AUTOSTRADËS TIRANË-ELBASAN”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë-Elbasan, në shumën prej 16 000 000 USD-sh.

Objektivat kryesorë të projektit për riparimet emergjente të punimeve civile për segmentit nr.1, Sauk – Hyrje, Tuneli i Kërrabës, janë sigurimi i rrjedhës së pandërprerë të trafikut lidhur me pjesën tjetër të rrugës Tiranë-Elbasan, tashmë të përfunduar, ulja e kostos operative të automjeteve, ulja e aksidenteve rrugore, kursimi i kohës së udhëtimit dhe realizimi i rritjes ekonomike në zonën e projektit. Riparimi emergjent i punimeve civile do të lejojë, gjithashtu, vënien në përdorim të plotë të rrugës Tiranë-Elbasan, me gjatësi prej 27 km, për të lehtësuar trafikun, duke siguruar mundësi më të shpejtë arritjeje në zonat bregdetare, në terrenet malore dhe zonat rurale të Elbasanit, si dhe do të sigurojë një lidhje të rëndësishme me Maqedoninë dhe Greqinë fqinje, duke rritur aktivitetet tregtare, transitin dhe turizmin në Shqipëri.

Afati për përdorimin e këtij financimi shtesë, që do të akordohet nëpërmjet marrëveshjes në fjalë, është deri në datën 31 dhjetor 2019.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektakt nuk është përfshirë në programin analitik të akteve për vitin 2018.

III. LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nevoja për financim shtesë ka ardhur si rezultat i problematikave të shumta që janë hasur gjatë zbatimit të këtij projekti. Shkaqet kryesore që kanë ndikuar në mosfinalizimin e projektit lidhen me problemet gjeologjike, e konkretisht, rrëshqitjet në km 11+100 (Ibë), km 13+150, km 14+000, si dhe lëvizjet gjeoteknike në zonën e Mulletit, km 4+000.

Bazuar në analizat financiare të gjendjes aktuale të fondeve, për përfundimin e plotë të veprës, do të duhet të akordohen fonde shtesë në vlerën prej 16 000 000 USD-sh. Në këtë vlerë përfshihen realizimi i punimeve civile emergjente, si pasoje e fenomeneve gjeologjike, të cilat reflektojnë humbjen e qëndrueshmërisë së shpateve rrugore dhe sollën si pasojë aktivizimin e rrëshqitjeve përgjatë gjurmës së projektit, shërbimet e konsulencës dhe të njësisë së zbatimit të projektit.

Për realizimin e punimeve civile emergjente është parashikuar një fond prej 14 860 000 USD-sh, nëpërmjet të cilit do të financohen punimet civile emergjente që do të kryhen për kompletimin e segmentit 1, me një gjatësi prej 13 km, të rrugës Tiranë–Elbasan, veçanërisht për përfundimin e rehabilitimit të rrëshqitjeve në km 4+000 (Mullet), km 11+000 (Ibë), km 12+000, km 13+150, km 14+150. Gjatësia totale e zonave problematike, ku është i nevojshëm përfundimi i rehabilitimit, është 4 km. Zërat kryesorë që kanë peshën më të madhe në këto punime janë gërmimet, riprofilimet e skarpateve, si dhe aplikimi i masave mbrojtëse ndaj tyre të cilat stabilizojnë përfundimisht rrëshqitjet e shpateve rrugore, spostimet e rrjeteve të shtyllave të tensionit të lartë, studimet dhe monitorimet gjeologjike e gjeoteknike, mbrojtjet e zonës lumore etj.

Për shërbimet e konsulencës është parashikuar vlera prej 1100 000 USD-sh për periudhën kohore deri në dhjetor të vitit 2018, si dhe për një vit periudhë defektesh. Për shpenzimet e njësisë së menaxhimit të projektit është parashikuar fond prej 40 000 USD-sh, i cili është i nevojshëm për periudhën e defekteve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Hartimi i projektligjit bazohet në nenet 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja e huas është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave, me anë të vendimit nr.502, datë 29.8.2018, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Në përputhje me ligjin nr.43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, marrëveshja do t’i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.

Nisur nga rëndësia e projektit, i cili duhet të fillojë të implementohet sa më parë, gjë që e bën të nevojshme bërjen efektive sa më parë të financimit që akordohet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, bazuar në nenin 83, pika 2, e Kushtetutës, propozojmë procedurë të përshpejtuar të shqyrtimit dhe miratimit të projektligjit nga Kuvendi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë-Elbasan, në shumën prej 16 000 000 USD-sh.

Financimi do të jepet në formë huaje në shumën prej 16,000,000 dollarë, dhe synon të realizojë mbulimin e kostove totale të projektit për riparimin emergjent të punimeve civile për segmentit nr.1, Sauk - Hyrje, Tuneli i Kërrabës.

Marrëveshja bashkëlidhur projektligjit përmban 4 nene dhe 3 skedule.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e ligjit ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Huaja që do të sigurohet nga Fondi i OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar ka termat e mëposhtëm:

- Shuma e financimit: 16 000 000 USD;
- Interesi: 2.75 % normë vjetore;
- Tarifa e shërbimit 1% normë vjetore që aplikohet mbi shumën e disbursuar dhe të pashlyer të kredisë;
- Maturimi: 20 vjet, duke përfshirë periudhën prej 5 vjetësh pa pagesë principali.

Në zbatim të ligjit nr.109, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, si dhe udhëzimit plotësues nr.2, datë 19.1.2018, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, është planifikuar dhe është i çelur buxheti për financimin e huaj të projektit.

KËSHILLI I MINISTRAVE